



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 2166/1 Prot

Tiranë më, 16 05.2018

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 4 - mujorin e vitit 2018.

Drejtuar: **Znj. Gelardina PRODANI**
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCEVE

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për 4-mujorin e parë të vitit 2018, është mbështetur në kërkesat institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat, në përputhje me ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si më poshtë vijon;

Inspektoratit të Lartë në zbatim të ligjit nr.109/2017, “Për Buxhetin e vitit 2018” dhe Udhëzimit nr.2, datë 19.01.2018, «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018», i është akorduar një fond buxhetor prej 138 milion e 349.1 mijë lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 102 milion e 500 mijë lekë (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15 milion e 700 mijë lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 16 milion e 760 mijë lekë (zëri 602)

Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)

Transferime korrente: 389.1 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti është akorduar për programin “Menaxhim, Administrim, Planifikim” dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2018-2020.

Referuar buxhetit të vitit 2018, ILDKPKI në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion, do të realizojë objektivat e parashikuara, në funksion rritjes së cilësisë së

kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit, qëllimit dhe në përputhje me objektivat prioritare të institucionit.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 19.01.2018, «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018», për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë, ka realizuar vlerën buxhetore në 41,051,739.97 lekë ose 79.02% të fondit të planifikuar për 4-mujorin e parë të vitit 2018.

| Llog Ek | Përshkrimi | Plan-Buxheti vjetor 2018 | Plan-Buxheti 4-mujor 2018 | Buxheti i realizuar 4-mujor 2018 | Realizimi në % si 4-mujor |
|--------------|-----------------------------------|--------------------------|---------------------------|----------------------------------|---------------------------|
| 600 | Fond Page | 102,500.00 | 37,100.00 | 31,939,785.00 | 75.51% |
| 601 | Kontrib.Sig.Shoq & Shend | 15,700.00 | 5,200.00 | 4,435,301.00 | 85.29% |
| 602 | Shpenzime operative | 16,760.00 | 6,420.00 | 3,283,238.97 | 51.14% |
| 606 | Transferta per financime te tjera | 389.10 | 229.10 | 206,735.00 | 90.24% |
| 231 | Investime | 3,000.00 | 3,000.00 | 1,186,680.00 | 39.56% |
| Shuma | | 138,349.10 | 51,949.10 | 41,051,739.97 | 79.02% |

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë 4-mujorit të vitit 2018, numri mesatar i punonjësve është realizuar 70 vetë, nga 70 vetë të miratuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 31,939,785 lekë ose 75.51% e fondit të planifikuar për periudhën Janar-Prill 2018 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 4,435,301 lekë ose 85.29% %, e planifikimit për periudhën respektive.

Fondi për shpenzime në zerin investime (zeri 231),

Gjithsej fondi i planifikuar i investimeve për vitin 2018, është 3 milion lekë dhe për 4-mujorin e parë është realizuar prokurimi i vlerës prej 1,500,000 lekë ose 50% e fondit të planifikuar për vitin 2018.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2018, për periudhën respektive ka prokuruar fondet e planifikuara të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit si më poshtë;

1. Fondi i investimeve me objekt “Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, është prokuruar, me procedurën kërkesë për propozim, me fond limit në vlerën 1,500,000 lekë dhe fituar nga shoqëria private “BNT ELECTRONICS“ Shpk, në vlerën 1,186,680 lekë ose 79.1% të fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe nr.1233prot. datë 9.3.2018.
2. Fondi i investimeve me objekt “Blerje Kondicioner Profesional me Precizion të Lartë”, është miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 1,500,000 lekë me tvsh. Në mbështetje të Regjistrin të Parashikimeve të Prokurimeve Publike, kjo vlerë do të prokurohet për periudhën në vazhdim.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zeri 602)

Për periudhën respektive, për këtë zë të shpenzimeve është prokuruar vlera 5,382,246 lekë ose 83.8%% e fondit me tvsh, si 4-mujor. Gjithsej është realizuar vlera prej 3,283,238.97 lekë ose 51.14% e fondit të planifikuar si 4-mujor, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi si më poshtë vijon;

- Fondi i parashikuar për grup artikullin shërbim me objekt "*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është realizuar me procedurën "*Kërkesë me Propozim*" me fond limit - 3,074,651 (*tre milion e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një*) lekë pa tvsh, nga buxheti i shtetit, me Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër dhe është është fituar nga AK, Eurogjici – Security, në vlerën 3,499,164.48 (*tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e nënëte mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër pik dyzet e tetë*) lekë me TVSH, si oferta e suksesshme. Likujdimi kryhet cdo muaj, në mbështetje të kontratës dypalëshe nr.1911 Prot, datë 20.4.2018.

ILDKPKI, në zbatim të Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006, "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, VKM nr.914 date 29.12.2014 "*Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik*", i ndryshuar, për nevojat e fillim vitit me shërbimin e ruajtjes me roje civile deri në kryerjen dhe përfundimin e procedurave të prokurimit me këtë objekt, ka realizuar;

- kontratë shtesë në vlerën e 20% të kontratës fillestare, me objekt "*Ruajtja dhe sigurimi i godines te ILDKPKI me roje objekti 24 orë*", në vlerën 512,745 (*pesëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë*) lekë me tvsh, me operatorin ekonomik "*International Security Albania*" Shpk, vlerë kjo e realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikimet e kontratës, si dhe,
- kontratë me objekt "*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*" për godinën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për periudhën, (7.3.2018 – 7.4.2018), fituar nga operatori ekonomik "*International Security Albania*" sh.p.k, në vlerën 291,592.64 (*dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëtëdhjetë e dy pik gjashtëdhjetë e katër*) lekë me tvsh, vlerë kjo e realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikimet e kontratës.
- Fondi i parashikuar për grup artikullin "*Blerje materiale kancelarie*", me fond limit për 800 mijë lekë, është realizuar me procedurën e blerje me vlerë të vogël dhe është fituar nga firma privatme "*Infosoft Office*" sh.p.k në vlerën 750 mijë lekë me tvsh ose 93% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.

Gjatë periudhës respektive, shpenzimet në zërin shërbime të ndryshme janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shpenzim i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, gjeneratori e tj. të cilat institucioni ynë, i ka likujduar në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni ynë për këtë periudhë, i ka realizuar sipas nevojave konkrete, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

- 1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat, në përputhje me ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” nga subjekte në sektorin publik dhe privat. Për 4 mujorin e parë të vitit 2018, janë 25 raste, në vlerën 4,030,000 lekë.
- 2) Ekzekutimi i detyrueshëm nga Zyrat Përmbartimore të rretheve për gjokat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore si dhe vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë.
Për këtë periudhë të vitit, janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 104 raste, në vlerën 15,816,561 lekë, nga të cilat 70 raste në vlerën 11,016,561 lekë, kanë kaluar në llogari të të ardhurave të ILDKPKI. Arkëtimi në favor të ILDKPKI, i 34 rasteve të tjera, të cilat përbëjnë vlerën 4,800,000 lekë, është në proces likuidimi.
- 3) Të ardhura të tjera të cilat për periudhën respektive, janë në vlerën 23,280 lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për 4 mujorin e parë të vitit 2018, janë në vlerën 15,069,841 lekë.

Të gjitha të ardhurat, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 dt.28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

Menaxhimi efektiv i fondeve buxhetore të akorduara për ILDKPKI, në funksion të një vendimmarrje transparente në kontrollin e deklarimit të pasurive, legjitimitetin e burimeve të krijimit, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët dhe personat e lidhur me ta, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave të zyrtarit, në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe arritja e standarteve më të mira, do të vazhdojë të jetë një faktor i rëndësishëm në realizimin e punës, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore për përmbushjen e objektivave institucionale.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Kozeta NDOI



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.7: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve Buxhetorë

ne 000 leke

| Institucioni | Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | Kodi i Grupit 76 | | |
|--|--|-------------------------|----------------------|------------------|----------|
| Programi | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | | Totali I Shpenzimeve | | |
| Artikulli | | Buxheti Perfundimtar | Fakti | Diferenca | |
| kodi | Emri | VITI 2018 | 4 - MUJORI | 2018 | |
| 600 | Paga | 102,500 | 31,939.80 | 70,560.20 | |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 15,700 | 4,435.30 | 11,264.70 | |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 16,760 | 3,283.20 | 13,476.80 | |
| 603 | Subvencione | | | - | |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | - | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | - | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 389.10 | 206.70 | 182.40 | |
| Neu-Totali | Shpenzime Korrente | 135,349.10 | 39,865.00 | 95,484.10 | |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | - | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 3,000.00 | 1,186.70 | 1,813.30 | |
| Neu -Totali | Shpenzime Kapitale | 3,000.00 | 1,186.70 | 1,813.30 | |
| | | | | - | |
| Totali | Korrente dhe Kapitale | 138,349.10 | 41,051.70 | 97,297.40 | |
| Jashte Buxhetore | | | 0.0 | 0.0 | - |
| Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore) | | 138,349.10 | 41,051.70 | 97,297.40 | |

| | | | |
|--------------|------------|-------------|-----------|
| Sekretari i | Emri: | Kozeta NDOI | |
| Pergjithshem | Nenshkrimi | | |
| | Data | | 16.5.2018 |

Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.8: Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

ne 000 leke

| Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | | | | |
|--|-----------------------------------|-------------------|-------------------|----------------------|------------------|------------------|
| Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | | | | Kodi i Grupit 76 |
| Programi | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | Buxhet | | Totali I Shpenzimeve | | |
| Programi | | PBA | I Planifikuar | Buxheti | Fakti | Diferenca |
| Titulli | Emri | PLAN | 2018 | Perfundimtar | 4- MUJORI | 2018 |
| | | 2018 | 2018 | 2018 | 2018 | 2018 |
| 01110 | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | 138,200.00 | 138,349.10 | 138,349.10 | 41,051.70 | 97,297.40 |
| Totali | Shpenzime të miratuara | 138,200.00 | 138,349.10 | 138,349.10 | 41,051.70 | 97,297.40 |

| | | |
|-----------------------------|------------|-------------|
| Sekretari i Pergjithshem | Emri: | Kozeta NDOI |
| | Nenshkrimi | |
| | Data | 16.5.2018 |



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.9 Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit

ne 000 leke

| | | | | | | | | |
|--------------|--|----------|-----------------|--------------------------------------|-----------------|------------|---------------|--------------|
| Institucioni | Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | | | | Kodi i Grupit | 76 |
| Programi | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | | | Titulli | 01110 | | | |
| Kodi | | Njesi | Sasia | Sasia | Realizimi | | | |
| Rezultatit | Emri I Rezultatit | Matese | e Planifikuar | Prokuruar gjithsej 4- Mujori 2018 | Plotesisht | Pjeserisht | Aspak | Komente |
| M760024 | Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike | 000/leke | 1,500 | 1,186.68 | 1,186.68 | | | perfunduar |
| M760038 | Blerje kondicioner profesional | 000/leke | 1,500 | | | | x | Ne proc prok |
| | | | | | | | | |
| | Totali (kapitale) | | 3,000.00 | 1,186.68 | 1,186.68 | | | |

| | | |
|--------------|------------|-------------|
| Sekretari i | Emri: | Kozeta NDOI |
| Pergjithshem | Nenshkrimi | |
| | Data: | 16.5.2018 |



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2018

Shtojca Nr.10: Raporti I i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Rezultateve

| Institucioni | | Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit | | | | Kodi i Grupit | | 76 |
|--------------|--|--|----------------|-------------------|-----------------|--------------------------|-----------------|-----------|
| Programi | | Planifikim, Menaxhim ,Administrim | | Titulli | | 01110 | | |
| Kodi | Emri I Rezultatit | Shpenzimet e Rezultatit | | | | Kosto per njesi 000/leke | | |
| | | PBA | Pl.Buxheti | Pl.Buxheti | Fakti 2018 | Kosto per njesi | Kosto per njesi | Shpjegime |
| Projektit | | Plan 2018 | Fillestar 2018 | Perfundimtar 2018 | 4-M i prokuruar | Plan 2018 | Fakt 2018 | |
| M760024 | Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike | 1,500.0 | 1,500.0 | 1,500.0 | 1,186.68 | 166.70 | 131.85 | likujduar |
| M760038 | Blerje kondicioner profesional | 1,500.0 | 1,500.0 | 1,500.0 | | | | |
| | Totali (kapitale) | 3,000.0 | 3,000.0 | 3,000.0 | 1,186.68 | | | |

| | | |
|--------------|------------|-------------|
| Sekretari i | Emri: | Kozeta NDOI |
| Pergjithshem | Nenshkrimi | |
| | Data: | 16.5.2018 |

